



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 49

Prishtinë, më 04.05.2012, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Anton Quni, Fatmir Xhelili, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur, më 13.04.2012
3. Shqyrtimi i Raportit të Ministrit të Punëve të Brendshme lidhur me situatën e sigurisë;
4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011;
5. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.*

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtura, më 13.04.2012

Kryetari i Komisionit- A ka vërejtje për procesverbalin e datës 13.04.2012?
Meqenëse nuk ka vërejtje, e konsiderojmë të miratuar procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13.04.2012.

3. Shqyrtimi i Raportit të Ministrit të Punëve të Brendshme lidhur me situatën e sigurisë.

Kryetari i Komisionit- Raporti ka ardhur në kohë, për Raportin do të jap përshtypjet e mija, citoj Raportin, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës konfirmon se ka adresuar rekomandimet e Komisionit të dala nga takimi i datës 13.04.2012, për ndërmarrjen e masave konkrete në drejtim të vendosjes së rendit kushtetues dhe të sundimit të ligjit në komunat e veriut të vendit.

Raporti në përgjithësi konfirmon situatën shumë të tensionuar të tri komunat veriore përfshirë edhe pjesën veriore të Mitrovicës. Sipas këtij Raporti shihet që MPB dhe Policia e Kosovës kanë hartuar plane operative të cilat i kanë paraqitur në Raport dhe kanë ndërmarrë disa hapa për ngritjen e nivelit të sigurisë në pjesën veriore të vendit, në veçanti me zonat e banuara me popullsi të përzier, ceket “lagjja e minatorëve, tre rrokaqiejve, boshnjakeve, kroi i Vitakut ” duke rritur numrin e patrullave si dhe duke shtuar numrin e policëve në Stacionin Policor në qytetin e Mitrovicës. Gjithashtu njësitë speciale operative të rajonit të Mitrovicës janë në gjendje gatishmërie me qëllim të reagimit sipas nevojës.

Sa i përket ngritjes së Këshillave Komunale për siguri në tri komunat veriore deri më tani nuk është bërë asgjë. Bashkëpunimi i Drejtorisë rajonale të Policisë së Mitrovicës me komunat në veri sipas këtij Raporti, nuk ekziston fare. Ndër çështjet më shqetësuese në këtë Raport është mos përmbushja e detyrave për ofrimin e sigurisë për qytetarët nga ana e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës në veri të Mitrovicës, Zveqan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

Sa i përket këtij problemi, sipas këtij Raporti Policia e Kosovës ka pasur mundësi vetëm të intensifikoj bashkëpunimin me EULEX-in dhe KFOR-in, duke kërkuar nga ta që të shtojnë numrin e patrullimeve. Gjithashtu Policia e Kosovës ka përgatitur urdhrin operativ përmes të cilit ka paraparë masa të nevojshme për parandalimin e organizimit të zgjedhjeve ilegale serbe në Republikën e Kosovës. Qeveria e Kosovës është pajtuar me vendimin që OSCE-ja të bënë vëzhgimin e zgjedhjeve në veri.

Sa i përket neutralizimit të strukturave kriminale dhe ilegale, Raporti përmban informacione për arrestimin e një grupi pjesëtarësh të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, në Partesh si dhe arrestimin të ashtuquajtur “Shef i Qarkut të Kosovës”. Të gjithë këta persona janë arrestuar në pjesën jugore e vendit dhe të gjithë janë liruar nga Gjykatat përkatëse me procedurë të rregullt.

Si Komisioni, për këtë pjesë duhet të kemi vërejtje se pse lirohen ata që konsiderohen se kanë bërë vepra kriminale dhe se kanë vepruar në kundërshtim me rendin dhe ligjin në territorin e Republikës së Kosovës.

Si përfundim, në bazë të informacioneve që përmban ky Raport përfundon në sa vijon:

Sa i përket sigurisë së qytetarëve, rendit kushtetues dhe sundimit të ligjit në pjesën veriore institucionet e Republikës së Kosovës e në veçanti MPB dhe Policia e Kosovës, nuk është në gjendje të përmbush obligimet kushtetuese dhe ligjore, kjo fushë edhe sipas Raportit mbulohet tërësisht nga EULEX-i dhe KFOR-i.

Shumica e pjesëtarëve serb të Policisë së Kosovës, nuk përmbushin detyrat dhe obligimet ligjore dhe nuk janë nën kontroll të plotë të zinxhirit komandues të Policisë së Kosovës edhe pse paguhen nga buxheti i Kosovës. Bashkëpunimi mes Drejtorisë policore rajonale të Mitrovicës me strukturat komunale në veri të vendit pothuajse nuk ekziston, ndërsa sa i përket neutralizimit të strukturave kriminale dhe ilegale në veri të vendit, Raporti nuk ofron asnjë informacion për ndonjë hap konkret të ndërmarrë nga ana e Policisë së Kosovës në këtë drejtim.

Në Raport cekët vetëm arrestimi i disa pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë në Rajonin e Gjilanit, por nuk ka informacion nëse një gjë e tillë mund të pritët në pjesën veriore të vendit.

Sipas Raportit, MPB, Policia e Kosovës ka hartuar plane operative për shtrirjen e rendit kushtetues dhe sundimit të ligjit në pjesën veriore, ndërsa mbetet të shihet implementimi i tyre.

Duke u bazuar në këtë Raport, mund të them që është i paraqitur reale gjendja në pjesën veriore të Kosovës, por sa i përket ndërmarrjes së masave është e vërtetë që është shtuar interesimi për ngritjen e sigurisë për këtë pjesë të vendit. Ndërsa, sa i përket sigurisë së qytetarëve, shtrirjes së kushtetutshmërisë dhe sundimit të ligjit në pjesën veriore të vendit, kemi më shumë prezencë të KFOR-it, EULEX-it, të cilët e garantojnë sigurinë dhe ekzistimin e bandave dhe institucioneve ilegale serbe që veprojnë në pjesën veriore.

Rexhep Selimi- Përshkrimi i gjendjes në veri të vendit në Raporti i përafrohet realitetit, kur përshkruan gjendjen në veri si të rëndë dhe ri-konfirmon gjendjen e rëndë në Komunitatet veriore të Kosovës, krahas kësaj Raporti ka disa pasaktësi në disa të dhëna.

Ka pasaktësi kur thuhet që, si kundërpërgjigjeje ndaj situatës për të ofruar sa më shumë siguri kemi ngritur pika statike. Çështja e pikave statike është publike, dhe kemi parë se

sa kanë qëndruar këto pika statike, dhe duke qenë e tillë nuk është dashur që ti paraqitet Komisionit si një masë me të cilin MPB të thirrej. Për pikën statike, Ministri i Punëve të Brendshme, është dashur të raportoj se pse kjo pikë nuk qëndroi e cila u ngrit pas aktit terrorist ndaj familjes së z. Selver Haradinaj. Një aspekt tjetër është që Qeveria fillimisht e ka konsideruar këtë akt si terrorist, ndërsa në Raport nuk i referohet si i tillë.

Sidoqoftë, e rëndësishme është ndërmarrja e masave kur duhet të cilësohet si i tillë për shkak se situata është e rëndë dhe kemi të bëjmë me grupe terroriste. Një gjë që i demanton deklaratat publike të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Qeverisë për funksionimin e zinxhirit komandues në veri, ë Raport konfirmohet se zyrtarët e Policisë së Kosovës nga radhët e komunitetit serb nuk i përmbushin funksionet e tyre në ofrimin e sigurisë, pra Ministria e pranon por nuk tregon për masat që ka ndërmarrë për të mos vazhduar kështu.

Në sferën e ndërmarrjes së masave për të luftuar krimin në veri, Ministri i MPB-së i referohet një arrestimit për në pjesën jugore, përkatësisht në Partesh. Ne e mbështesim këtë veprim, arrestimin e pjesëtarëve të Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë, me dyshimin e bazuar për shkelje të rendit kushtetues në territorin e Kosovës, por të merret si sukses arrestimi në pjesën lindore dhe të hiqet dorë nga pjesa veriore, nuk konsiderohet si një raportim dhe përgjigje ndaj Komisionit.

Nga paraqitjet publike është përmendur që janë tri pika që Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme në një plan operacional e ka bërë parandalimin e zgjedhjeve serbe në Kosovë, ndërsa Raporti thekson që Policia e Kosovës ka përgatitur urdhrin operativ përmes të cilit ka paraparë masa dhe vendime policore për parandalimin e organizimit të zgjedhjeve ilegale serbe në Republikën e Kosovës, të paralajmëruara për datën 6 maj 2012.

Duket si jo logjike deklarimi i Ministrit për parandalimin e zgjedhjeve në atë pjesë kur nuk është prezent, përjashtuar lagjet ku popullata është e përzier. Sidoqoftë, Raporti i MPB-së nuk i hynë shumë në punë Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, pasi nuk është e nevojshme mbajtja e linjave të tilla sa për të thënë, pasi Ministria e Punëve të Brendshme duhet të jetë me esenciale në bashkëpunim me Komisionin.

Një shqetësim tjetër që paraqitet në Raport është që gjendja e tensionuar paraqitet në pjesët ku është e pranishme popullata shqiptare prezent, siç janë “Kodra e Minatorëve” “Lagjja e tre rrokaqiejve” “Lagjja e Boshnjakëve” dhe “Kroi i Vitakut” duke hequr dorë nga pjesët e tjera ku nuk ka shqiptar. Mendoj që edhe për këtë pjesë duhet kujdesur, pjesë e cila është spastruar nga shqiptarët.

Raportin e vlerësoj real për paraqitjen e gjendjes si të rëndë në pjesën veriore të vendit, ndërsa për të dhënat statistikore vlerësoj që nuk e ka saktësinë e duhur dhe të dhëna që i duhen Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së. Presim që Ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme ta kemi prezentë në Komision duke i adresuar pyetje dhe çështje ndaj të cilave ka obligim ti paraqesë në Komision.

Fatmir Xhelili- Raporti i Ministrit të MPB-së për situatën në tri komunat veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Mitrovicë është raport real dhe konsideroj që është përshkrues më shumë sesa vlerësues. Nga rekomandimet e Komisionit për Punë të brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, Ministri me ekipin e tij ka shqyrtuar këto rekomandime dhe ka adresuar për institucionet të cilat janë përgjegjëse për realizimin e rekomandimeve, përkundër deklaratave në Media që Ministri nuk është obligues ndaj rekomandimeve të Komisionit.

Hartimi i Planeve nga Policia e Kosovës për situata parashikuese që mund të ndodhin në pjesën veriore është hap i mirë. Si Komision duhet të jemi të vetëdijshme që ky është proces në zhvillim dhe se situata në këtë pjesë nuk mund të rregullohet për një kohë të shkurtër, pasi për përmirësimin e kësaj situatë janë të përfshirë një sërë faktorësh që janë ndikues në rrjedha politike dhe të sigurisë.

Kërkesa e disa anëtarëve të Komisionit për kërkimin e përgjegjësisë në veri të vendit. Për këtë dua të sqaroj, sqarim i cili është edhe në dokumentet e Kuvendit të Kosovës që përgjegjës për siguri është KFOR-i, përgjegjës për ruajtjen e rendit publik në tri Komunat në veri është EULEX-i. Transformimi i kompetencave prej komponentës policore të EULEX-it tek Policia e Kosovës ende nuk ka ndodhur për këto tri Komuna, pasi komponenti i Policisë së Kosovës për këto tri Komuna është ndihmëse në realizimin e ruajtjes së rendit përgjegjës për të cilin është EULEX-i.

Transferimi i kompetencave bëhet me vlerësim, me nënshkrim të bartjes dhe autorizimit të përgjegjësive. Atëherë kur Policia e Kosovës ti merr kompetencat për ruajtjen e rendit në këto tri komuna atëherë llogaridhënia e Policisë së Kosovës duhet të bëhet në organet e Kosovës për situatën atje.

Kur u paralajmërua se Policia e Kosovës do të ndërmerr një aksion në veri të vendit, nga KFOR-i u vëzhgua situata nga afër në mënyrë që mos të ndërmerret ndonjë veprim pa kompetenca ligjore për të zgjidhur situatën.

Pajtohem me konstatimet e Kryetarit për Raportin, me përjashtim të pjesës kur thotë që “në tri Komunat veriore Qeveria e Kosovës nuk është në gjendje që ti përmbush obligimet kushtetuese dhe ligjore”. Qeveria e Kosovës është në drejtim të realizimit dhe përmbushjes së obligimeve ligjore në bazë të vendimit të Kuvendit të Kosovës ku ingerencat për Prokurorinë Speciale dhe për disa komponentë të Policisë së EULEX-it, dihet që janë akoma tek EULEX-i, dhe se në zinxhirin komandues të institucioneve të Kosovës nuk është EULEX-i dhe komponenti policor i tij.

Përkrah idenë që Qeveria dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës të jenë syçelë në fazën kur do të mbahen zgjedhjet serbe në pjesën veriore, dhe se jemi të vetëdijshëm që ka tendenca për destabilizimin e situatës në këtë pjesë dhe ndoshta edhe në vendet fqinje. Përveç disa vërejtjeve, mendoj që Raporti është përshkrues dhe real i gjendjes në veri, dhe se rastet që kanë ndodhur atje si vrasja e policit në aksionin e 25 korrikut 2011, sulmi ndaj familjes së z. Selver Haradinaj, do të shërbejnë si përvojë në planin

parashikues të Policisë dhe të komponentëve të sigurisë për veprimet eventuale në pjesën veriore. Si Komision duhet të insistojmë që të bëhet identifikimi i pjesëtarëve të grupeve vandale, siç ishte rasti i djegies së Portës 1 dhe 31 me rastin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe kronologjinë e ngjarjeve dhe veprave, është koha që të ngjiten padi ndaj individëve dhe grupeve që i kanë shkaktuar këto vepra.

Me ndryshimin e Kodit Penal, ku parashihen ndëshkime për aktivitetet të cilat janë kundër rendit kushtetues, do të mundësojnë organeve zbatimin e ligjit, arrestimin dhe ndëshkimin e tyre. Nuk mendoj që është funksionale që Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme të ftohet shpesh në Komision, pasi kjo mund të devalvoj institucionin e referimit të Ministrit pranë Komisionit, referimi në Komision duhet të jetë i kohë pas kohshëm, pasi institucionet e sigurisë kanë arritur një pjekuri. Policia e Kosovës është e përgatitur për të ballafaquar me situata të ndryshme, edhe pse është tentuar që të devalvohet fuqia dhe kapaciteti i saj ndaj prishësve të rendit.

Ganimete Musliu- Raporti i Ministrisë së Punëve të Brendshme, është real dhe përshkruar bazuar në rekomandimet e adresuara nga Komisioni për Ministrinë. Pajtohem me konstatimet e Kryetarit për Raportin, por veçoj pjesën në Raport ku thuhet që “Policia e Kosovës me 25 shkurt 2012 ka arrestuar në Komunën e Parteshit një grup të pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë”, vërejtjet që u bënë ishin se ata janë liruar, por në Raport përshkruhet ngjarja dhe se Policia e Kosovës e ka kryer detyrën, ndërsa për lirimin e tyre pyetja duhet të adresohet në organet e drejtësisë që merren me shqyrtimin e këtyre rasteve.

Gjithashtu vlerësoj që raporti ka ardhur në kohë dhe se si anëtarë të Komisionit duhet të jemi të matur me deklarata dhe kritika në situatën aktuale, pasi situata në veri është e akumuluar pas luftës e deri tani.

Rexhep Selimi- Ne e dimë përgjegjësinë e KFOR-it për siguri në Kosovë, e cila është mbështetur në Marrëveshjen tekniko-ushtarake të Kumanovës, nuk e di sa është përgjegjës EULEX-i për rendin publik, pasi i dedikohet më shumë ligjit dhe mbështetjes së policisë, por në momentin pajtohem se ka përgjegjësi për rendin përfshirë edhe tri Komunat, por nuk kuptoj cili është roli i Policisë së Kosovës për këto tri Komuna.

Nëse për momentin e pranojmë që Policia e Kosovës nuk ka transferuar kompetencat për rend dhe ligj në tri Komunat, atëherë ndërhyrja e 25 korrikut si mund të shpjegohet. A i tejkaloi kompetencat Policia e Kosovës?

Ftesat e shpeshta të Komisionit për Ministrinë e MPB-së e konsolidojnë raportin mes këtyre dy institucioneve, pas gjendja në veri është shqetësuese.

Fatmir Xhelili- Referuar Raportit, thuhet që Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe Këshillat lokale për siguri në bashkësi nuk janë formuar.

Konsideroj që mos formimi i këtyre Këshillave në tri komunat veriore është më mirë, pasi Këshillat formohen nga pushteti lokal, ku udhëheqës të këtyre Këshillave janë Kryetarët e komunave dhe pjesëtarët e policisë janë një prej anëtarëve të Këshillave Komunale, dhe nuk konsideroj të arsyeshme formimi i këtyre Këshillave nga Kryetarët e

Komunave të zgjedhur në mënyrë jo ligjore, pasi në të kundërtën do të konsiderohej pranim i këtyre strukturave.

Për komentet e z. Rexhep Selimi, për komponentin e EULEX-it që është përgjegjëse për ruajtjen e rendit në tri Komuna është e lehtë për tu verifikuar, ndërsa për aksionin e 25 korrikut 2011, Policia e Kosovës e ka zhvilluar këtë aksion për të dërguar zyrtarët e Policisë së Kosovës në pikat kufitare, në pikën 1 dhe 31, dhe pjesëtarët e policisë dhe doganieret vazhdojnë të jenë në këto pika.

Anton Quni- Vlerësoj përpjekjet e Ministrit për të paraqitur situatën në veri të vendit, por nga Raporti kuptohet që përpjekjet e Policisë së Kosovës janë të një natyre pasive dhe të gjithë veprimet e parapara nuk janë parandaluese, ndjekjes, hetimeve dhe neutralizimit por janë veprime të konstatimit të gjendjes. Mendoj që këto nuk janë veprime të mjaftueshme.

Duke ditur situatën në veri, nga Raporti kam pritur që të pasqyroj përpjekjet për motivimin e qytetarëve për të dorëzuar armatimin, pasi dihet që qytetarët në këtë pjesë janë të armatosura, me armë të lehta dhe të rënda.

Prandaj, Policia në bashkëpunim me mekanizmat ndërkombëtar, KFOR-in, EULEX-in OJQ-të, duhet të ndërmarrin mbështetjen e të gjitha institucioneve të Qeverisë së Kosovës dhe ndërmarrjen e hapave serioze në sensibilizimin e qytetarëve që të heqin dorë nga armët, pasi është Policia e Kosovës dhe institucionet e tjera që i ofrojnë siguri atyre.

Strukturat paralele, ilegale në veri kanë nevojë për fonde, aty ndodhin transaksione të ndryshme në favor të këtyre strukturave. Në Raport nuk është përfshirë ndonjë veprim për të ndërprerë këtë zinxhir të financimit të këtyre strukturave. Çështje tjetër është ndjekja, neutralizimi i kriminelëve. Duke e ditur potencialin e Policisë së Kosovës, nuk janë në gjendje ti arrestojnë, lokalizojnë individët për të cilët është vërtetuar që kanë marrë pjesë në vrasje dhe akte të ndryshme vandale.

Në veri gjithashtu veprojnë disa institucione të quajtura ilegale, ndër to janë edhe Gjykatat komunale dhe të qarkut. Vlen të theksohet vendimi i Gjykatës së qarkut të Mitrovicës e cila është nën juridiksionin e institucioneve të Beogradit, në vitin 2011 kanë marrë vendim me të cilin janë dënuar disa pjesëtarë të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Deri tek ky vendim, mbledhja e informatave, ekspertiza, dëshmia janë bërë në territorin e Kosovës. Paradoksi qëndron në faktin që këto vendime merren parasysht nga mekanizmat ndërkombëtar, siç është Interpoli. Ky rast nuk përbën interesim për Policinë e Kosovës që të ndërmerr masa për shuarjen e këtij institucioni.

Në veri të vendit gjithashtu janë edhe dy pika kufitare, 1 dhe 31 dhe se aksioni i 25 korrikut justifikohet me faktin se tani aty janë prezent doganierët dhe policët e Kosovës, po këta qëndrojnë të mbyllur në kontejner dhe nuk kanë qasje në kontrollin e transporteve që kalojnë në kufi, këto menaxhohen nga EULEX-i dhe njësitë e KFOR-it që ofrojnë siguri. Të gjitha këto çështje nëse nuk adresohen siç duhet nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga Policia e Kosovës dhe nuk mbështeten nga Qeveria e Kosovës nuk do të kemi sundim të ligjit në këtë pjesë.

Kryetari i Komisionit- Për arsye që kam takimin e radhës me Ambasadorin e Turqisë në Kosovë, më duhet të lë mbledhjen. Bazuar në Raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, duhet të dalim me një qëndrim të përbashkët për të. Mbledhja në vazhdim kryesohet nga Nënkryetari, z. Rexhep Selimi.

Ganimete Musliu- Në përgjigjeje të z. Rexhep Selimi për natyrën e deklaratave që bëjmë. Kjo mund konsiderohet si preventiv madje kjo duhet të merret parasysh edhe nga organet qeveritare.

4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011.

Nënkryetari i Komisionit- Për këtë pikë të rendit të ditës kemi shqyrtimi e Raportit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011, hap diskutimin për këtë çështje.

Fatmir Xhelili- Grupi punues ka shqyrtuar Raportin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011, kemi propozuar që ky Raport të pranohet nga Komisioni dhe të procedohet tutje. Përkundër asaj që ky Agjencion është themeluar vonë dhe ka pasur kohë të shkurtër për tu strukturuar.

Për këtë Raport kemi bërë disa vërejtje, si marrja e kuadrove nga institucionet e tjera dhe mos rekrutimi i kuadrove të reja, prandaj grupi punës rekomandon që ti rekruton kuadrot me konkurs duke mos dobësuar institucionet e tjera.

Vërejtje tjetër është për objektin e Agjencisë për të cilin paguhet qira. Rekomandimi është që Agjencia ti drejtohet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në mënyrë që të marrin një institucion, siç është objekti i ish-TMK-së, pasi personeli në këtë Agjenci është i vogël dhe mund të akomodohen lehtë.

Vjollca Krasniqi- Gjatë punës me grupin punues për këtë Raport, i cili më shumë ka qenë si program sesa si një Raport pune, kemi propozuar që Komisioni të pranon këtë Raport me rekomandimet e dhëna, duke shpresuar që të strukturohet më mirë.

Nënkryetari i Komisionit- Vlerësojmë që Komisioni e pranon këtë Raport me vërejtjet dhe rekomandimet e adresuara.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Nëse keni çështje për të ngritur në këtë pikë të rendit të ditës, ju ftoj ta bëni.

Ganimete Musliu- Desha të njoftoj që në emër të Komisionit isha në Ushtrimin Fushor të FSK-së, u bënë vërejtje për mos praninë e anëtarëve të tjerë të Komisionit.

Nënkryetari i Komisionit- Komisioni e vlerëson që ka qenë prezentë, duke qenë së ka qenë një përfaqësues i Komisionit dhe mungesa e tyre nuk ka qenë një arsye e përbashkët por e veçantë për secilin. Prandaj në emër të Komisionit e falënderoj znj. Ganimete Musliu për prezencën në këtë ushtrim fushor të FSK-së.

Fatmir Xhelili- Ftesat për këtë ushtrim fushor i kemi pranuar një ditë para, prandaj kur dërgohen ftesat duhet të bëhen në një kohë më herët për të menaxhuar kohën për të qenë prezent atje.

Ganimete Musliu- Gjatë mbledhjes së Komisionit është prezencë e madhe e monitoruesve, medias, shoqërisë civile, sugjeroj që të gjithë ata që marrin pjesë gjatë mbledhjeve të vendosin kartat e identitetit në mënyrë që të dihet së kush merr pjesë dhe merr informatat gjatë mbledhjeve.

Nënkryetari i Komisionit- Përkrah idenë e vënies së kartave të identitetit gjatë mbledhjes për të gjithë pjesëmarrësit.

Duke qenë se Kryetari nuk është i pranishëm, pas analizimit të Raportit të Ministrisë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka nxjerr disa përfundim i cili mund të ndryshohet me sugjerimet e anëtarëve të Komisionit. Citoj përfundimet:

Në bazë të informacioneve që përmban Raporti i Ministrisë së Punëve të Brendshme mund të përfundojmë si vijon:

- Sa i përket sigurisë së qytetarëve, rendit kushtetues dhe sundimit të ligjit në pjesën veriore, institucionet e Republikës së Kosovës e në veçanti Ministria e Punëve të Brendshme përkatësisht Policia e Kosovës nuk është në gjendje të përmbush detyrimet kushtetuese dhe ligjore. Kjo fushë edhe sipas Raportit mbulohet nga EULEX-i dhe KFOR-i.
- Shumica absolute e pjesëtarëve serb të Policisë së Kosovës nuk përmbushin detyrat dhe obligimet ligjore dhe nuk janë nën kontroll të plotë të zinxhirit komandues të Policisë së Kosovës edhe pse paguhet nga buxheti i Kosovës.
- Bashkëpunimi mes Drejtorisë Policore Rajonale të Mitrovicës me strukturat komunale në veri të vendit pothuajse nuk ekziston.
- Sa i përket neutralizimit të strukturave ilegale në veri të vendit, Raporti nuk ofron ndonjë informacion apo hap konkret të ndërmarrë nga Policia e Kosovës në këtë drejtim. Në Raport ceket arrestimi i disa pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë në rajonin e Gjilanit, por nuk ka asnjë informacion se një gjë e tillë mund të pritët në pjesën veriore të vendit.
- Sipas Raportit, Ministria e Punëve të Brendshme respektivisht Policia e Kosovës vetëm ka hartuar plane operative për shtrirjen e rendit kushtetues, sundimit të ligjit në pjesën veriore por mbetet të shihet implementimi i tyre. Duke u bazuar në këtë, mund të themi që Raporti është real por në të njëjtën kohë pasqyron realitetin e hidhur dhe sqaron që institucionet e sigurisë në pjesën veriore e në veçanti Policia e Kosovës janë prezent në veri vetëm në formë vizuale ndërsa sa i përket sigurisë së qytetarëve, shtrirjes së kushtetutshmërisë dhe sundimit të ligjit në pjesën veriore, mbetet nën mëshirën e EULEX-it dhe të KFOR-it.

Fatmir Xhelili- Propozoj që Raporti i Ministrisë së Punëve të Brendshme të pranohet në Komision me vërejtjet e bëra, mirëpo nuk vlerësoj që është e nevojshme një analizë e tillë e Raportit e cila nuk më duket e qëlluar.

Anton Quni- Mendoj që përfundimet e nxjerra janë përmbledhje e vërejtjeve që u bënë, por mendoj që është konfuze kur thuhet “bashkëpunimi me strukturat komunale” pasi nuk dihet për cilat struktura është fjala. Nëse mendohet për strukturat e Kosovës, kjo dihet që nuk i kemi këto, ndërsa nëse bëhet fjalë për strukturat serbe kjo është e pa pranueshme dhe këtë konstatim propozoj që të hiqet.

Mendoj që përfundimet e Komisionit mund ti shërbejnë Ministrit të MPB-së si mbulesë e fortë që në kërkesat e tij ndaj EULEX-it dhe KFOR-it të ketë një bashkëpunim, pasi të gjithë janë përgjegjës për situatën në veri.

Fatmir Xhelili- Fillimisht si Komision kemi dërguar rekomandimet tek Ministria, kemi pranuar Raportin për situatën në veri të vendit. Mendoj që duhet të presim për një periudhë kohore pasi këto çështje nuk mund të rregullohen për një kohë të shkurtër, prandaj nuk konsideroj që është e nevojshme dërgimi i këtyre përfundimeve, pasi duket sikur tentojmë të menaxhojmë strukturat e sigurisë, duke mos pasur këtë rol. Pranojmë Raportin me vërejtjet e bëra, duke pritur zhvillimet pasi Ministri ti ketë adresuar rekomandimet e Komisionit tek institucionet përkatëse.

Nënkryetari i Komisionit- Analiza e Kryetarit për Raportin qëndron, gjithashtu mendoj që Raporti i cili na është dërguar nga Ministria e Punëve të Brendshme nuk na është paraqitur për të na informuar neve si anëtar të Komisionit, ky Raport duhet të ketë vlerësimin nga Komisioni, qoftë vlerësim, analizë apo mospranim.

Anëtarët e Komisionit mund të kenë përshtypje të ndryshme për çështjet e njëjta, por vlerësimi i Raportit nga Komisioni duhet të vlerësohet dhe të analizohet, pasi për Raportin kemi një qëndrim të përbashkët duke parë që situata nuk ka shkuar drejtë përmirësimit.

Vlerësoj që situata në veri nuk ka shkuar duke u përmirësuar por duke u vështirësuar, gjithashtu zinxhiri komandues në këtë pjesë nuk është funksional në pjesën veriore, prandaj mendoj që vlerësimet tona të jenë në formë të shkruara për Raportin, pasi detyra jonë është shqyrtimi i këtij Raporti, duke dhënë vlerësime për të. Përfundimeve mund tu bëhen ndryshime, siç sugjerova në pikën ku thuhet “bashkëpunimi mes Drejtorisë Rajonale ë Mitrovicës dhe strukturave lokale në veri, i është referuar Kryetarëve të Komunave të zgjedhur nga komuniteti serb në veri. Vërejtja tjetër ka të bëjë me terminologjinë me të cilën është hartuar dokumenti, por këto vërejtje nuk e bëjnë të pavlefshme këtë analizë. Komisioni dhe anëtarët vendosin për formën përfundimtare, por nga praktika kemi dal me vlerësime të përbashkëta.

Ganimete Musliu- Nga praktika e Komisionit, nuk kemi bërë analizë me shkrim për Raportet, kemi shqyrtuar ato duke mbet pjesë e procesverbaleve në raste të tjera kemi

ftuar personat përgjegjës në Komision për të ofruar informacion. Nëse kjo praktikë do të ndiqet, propozoj që edhe për Raportin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të ketë një analizë të tillë dhe jo të bëhen dallime në Raporte dhe në analizimin e tyre.

Nënkryetari i Komisionit- Për Raportin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është formuar grupi punues dhe e mbështesim përfundimet që dalin nga grupi punues, por nuk mundet që Raporti nga Ministria e Punëve të Brendshme të na servilet si informacion.

Emin Gerbeshi- Raporti nga Ministria e Punëve të Brendshme është i pranueshëm dhe i arsyeshëm por Komisioni duhet të del me rekomandime dhe konkluzione dhe mendimi të jetë unik për vënien e kushtetutshmërisë në pjesën veriore të Kosovës, pasi Kosova tashmë është e pavarur dhe ka Kushtetutën që obligon vendosjen e rendit atje. Është e pa kuptimtë që tolerohet gjendja e tillë në veri nga KFOR-i, EULEX-i, kur dihet që aty bëhen aktivitete të paligjshme, gjithashtu nuk ka vendosmëri nga zyrtarët e Kosovës për këtë pjesë.

Fatmir Xhelili- Propozoj që të shkohet me konstatimin që Raporti është pranuar nga Komisioni dhe të autorizohet Ministria e Punëve të Brendshme të intensifikoj të gjitha obligimet që rrjedhin nga rekomandimet e dërguara nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Nënkryetari i Komisionit- Shqyrtimi dhe analizimi i Raportit mund të përmbyllet me përfundime pasi kjo është edhe detyra e Komisionit. Nëse nuk dalim me vlerësime dhe përfundime të përbashkëta mbetet që në takimet e radhës të ftohet Ministri z. Bajram Rexhepi i cili mund ti përgjigjet pyetjeve nga anëtarët e Komisionit.

Ganimete Musliu- Secili nga anëtarët ka dhënë vlerësimin për Raportin, konsideroj që nuk ka nevojë të dalim me shkresë të veçantë për këtë Raport por të mbetet pjesë e procesverbalit.

Anton Quni- Raporti i Komisionit me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Policinë e Kosovës është në formë të një cikli të vazhdueshëm. Kjo është një formë e komunikimit mes Komisionit dhe Ministrisë, përfundimet janë një përmbledhje e vërejtjeve të bëra, prandaj duhet të dalim me përfundime që përfaqësojë interesat e të gjitha partive politike dhe në mbështetje të MPB-së.

Fatmir Xhelili- Bazuar në Raportin i cili na është paraqitur si Komision, Ministria e Punëve të Brendshme është në zhvillim dhe në realizim e obligimeve ligjore por bazuar edhe në rekomandimet e dërguara nga Komisioni. Prandaj vlerësoj që konstatimi të jetë që raporti pranohet dhe presim realizimin e obligimeve kushtetuese, ligjore dhe rekomandimet e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Nënkryetari i Komisionit- Qëllimi është që të nxirren disa përfundime në mbështetje të Ministrisë së Punëve të Brendshme në drejtim të shtrirjes së rendit dhe ligjit në gjithë

territorin e Kosovës. Një mbështetje e tillë është dhënë me 28 korrik 2011 për Rezolutën në mbështetje të saj pa dallime politike.

Konkluzion i kësaj mbledhje është që ne pranuar Raportin, shqyrtuam, analizuam i dhamë vërejtjet secili veç e veç, Raporti konstaton një gjë që gjendja është e rëndë dhe e pa përmirësuar. Mbetet për tu theksuar pjesa e fundit e draft analizës ku thuhet që “Raporti është real dhe në të njëjtën kohë pasqyron realitetin jo të mirë, ku prezenca e Policisë së Kosovës në veri është prezent vetëm në formë vizuale ndërsa sa i përket sigurisë së qytetarëve, shtrirjes së kushtetutshmërisë dhe sundimit të ligjit në pjesën veriore, mbetet nën mëshirën e EULEX-it dhe të KFOR-it ”

Fatmir Xhelili- Nuk mendoj që duhet të bëhet një përkufizim i tillë për situatën në veri të vendit si e “keqe dhe e rëndë” , pasi vlerësimi duhet të bëhet me komponentët e sigurisë në veri. Mendoj që duhet të kemi kujdes në relacion me KFOR-in dhe EULEX-in, me partnerët ndërkombëtarë që janë të përfshirë për zgjidhjen e situatës në veri, pasi situata aty është e ndjeshme dhe varet siguria në rajon.

Propozoj që në mbledhjen e radhës të vazhdohet vlerësimi për raportin kur të jetë i pranishëm edhe Kryetari i Komisionit z. Ahmet Isufi.

Nënkryetari i Komisionit- Propozoj Komisionit që në mbledhjen e radhës të rishqyrtohet dhe të analizohet Raporti dhe përfundimet për të, ku të parashihet edhe debat për këtë çështje.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi